



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-Ministarstvo Sredine i Prostornog
Planiranja-Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of Generaly Secretary

DATË/A:	03.11.2016
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Komuna Junik
CC:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shqyrtimi i kërkesës nga Komuna e Junikut për Taksat për Leje të Ndërtimit për vitin 2017 me Nr.Protokolli 4771/16 të datës 28.10.2016.

Të nderuar,

Bazuar në shkresën e datës 28.10.2016 me numër protokolli 4771/16, lidhur me caktimin e taksës administrative për leje ndërtimore dhe tarifës për rritjen e densitet të infrastrukturës nga Komuna e Junikut (tutje si: Komuna), MMPH ka shqyrtuar dhe analizuar shkresën se bashku me dokumentacionin përcjellës dhe konstaton si në vijim:

Komuna ka propozuar Taksën Administrative të lejes ndërtimore në pajtim me Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110 dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 22/2012 për Lëshimin e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës.

Taksa Administrative për Lëshimin e Lejes se ndërtimit e llogaritur nga Komuna është **1.50 €/m²** (një euro e pesëdhjetë centë për metër katror).

Tarifa për rritjen e densitetit të infrastrukturës është llogaritur konform Shtojcës 3 të UA Nr.22/2012, dhe kjo Tarifë duhet të llogaritet vetëm për njësit e reja të banimit, konform formulës së përcaktuar në nenin 10, paragrafi 1 i UA nr.22/2012.

Komuna duhet të procedoj për aprovim taksat për lëshimin e lejes se ndërtimit në pajtim me procedurat e parapara me Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110.

Me respekt.

Faqe 1 nga 1